

**REZOLUTA
E MIRATUAR
NE KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE
“DEKRIMINALIZIMI I SHPIFJES: SHKËMBIM I PRAKTIKAVE POZITIVE”**

Shkup, 9-10 shkurt 2006

Më 9 dhe 10 shkurt, në Shkup u mbajt Konferenca “Dekriminalizimi i shpifjes: Shkëmbim i praktikave pozitive”. Konferenca u organizua nga Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, Instituti maqedon për media, ndërsa është përkrahur nga Misioni Vëzhgues i OSBE-së dhe Përfaqësuesi i OSBE-së për Liri të Mediave.

Zyrtarët qeveritarë, ligjvënësit, ekspertët ligjor dhe aktivistët e lirisë së medive nga disa shtete pjesëmarrëse të OSBE-së kanë diskutuar për zhvillimet pozitive në disa vende pjesëmarrëse të OSBE-së, të cilët tanimë kanë dekriminalizuar shpifjen apo janë në proces të sipër të marrjes së hapave të rëndësishme në mënjanimin e dënimit të arrestit për shpifje.

Në konferencë janë theksuar çështjet si: aspektet ligjore të dekriminalizimit të shpifjes, roli i shoqërisë civile në promovimin e ndryshimeve, arsyetimet dhe kufizimet e ndëshkimeve në Kodin civil, balansimi ndërmjet lirisë së shprehjes dhe mbrojtjes së reputacionit, mekanizmat vet-rregulluese, si dhe etika e gazetarëve. Këto diskutime janë bazuar në rekomandimet relevante të Përfaqësuesit të OSBE-së për Liri të Mediave.

Pjesëmarrësit kanë shprehur interesim të promovojnë dhe lehtësojnë ndryshimet e mundshme të Kodit penal lidhur me fyerjen dhe shpifjen, e cila është në përputhje me fushatën Përfaqësuesit të OSBE-së për Liri të Mediave kundër ligjeve penale për shpifjen dhe dëmshpërblimeve të tepruara dhe, poashtu është në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës, të pasqyruara nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut.

Pjesëmarrësit kanë vlerësuar ndihmën e dhënë nga ana e OSBE-së dhe kanë inkurajuar Misionin e OSBE-së në Shkup dhe Përfaqësuesin e OSBE-së për Liri të Mediave të vazhdojnë mbështetjen e zhvillimit të mediave dhe lirisë së shprehjes në vend.

Konferenca ka përfunduar me Rezolutë, e miratuar nga përfaqësuesit e Institutit maqedon për media, Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, qeveria, mediat, shoqëria civile, si dhe nga Misioni Vëzhgues i OSBE-së dhe Përfaqësuesi i OSBE-së për Liri të Mediave.

Pjesëmarrësit e Konferencës:

- mirëpresin dhe mbështesin angazhimin e Ministrisë së Drejtësisë për të vazhduar aktivitetet në përgatitjen e ndryshimeve të Kodit penal, në mënyrë që të ndryshojnë rregullat mbi ndëshkimet për shpifje, sidomos që të shfuqizohet arresti si dënim, si dhe kufizimi i gjobave. Ministria pret ndihmë edhe nga ekspertët ligjor dhe nga ekspertët tjerë;
- ofrojnë ndihmë për qeverinë, ekspertët ligjorë dhe aktivistët e lirisë së mediave dhe të shoqërisë civile në mënyrë që do të vlerësojnë situatën dhe do të krijojnë Grup punues nën udhëheqjen e Ministrisë së Drejtësisë që të hartojë dhe prezantojë amendamentet e legjislacionit para Parlamentit;
- theksojnë rëndësinë e përfundimit të bashkëpunimit ndërmjet gazetarëve dhe ekspertëve ligjor, si dhe ndërmjet shoqatave profesionale siç është shoqata e mediave elektronike private dhe shoqata e botuesve për vazhdimin e debatit publik, si dhe për edukimin e kolegëve të tyre dhe opinionin publik për praktikën e dekriminalizimit të shpifjes dhe parimet e lirisë së shprehjes;
- kërkojnë nga subjektet e rëndësishme për vendosje, përfshirë edhe gazetarët, redaktorët dhe pronarët e mediave, që të krijojnë organe vet-rregulluese efikase dhe të pavarura dhe t'i themelojnë për të qenë sa më funksionale për zgjidhjen e konflikteve lidhur me çështjen e shpifjes;
- do të vlerësojnë nëse ekziston interesim ndërmjet ekspertëve ligjor dhe gjyqtarëve për të përmirësuar njohuritë e tyre lidhur me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut;
- do të vërrenjë rolin e rëndësishëm të gjyqësisë së pavaruar në aplikimin e duhur të legjislacionit lidhur me mediat;
- janë të vendosur të vazhdojnë përmirësimin e standardeve profesionale dhe njohurinë e gazetarëve dhe të profesionistëve tjerë të mediave gjatë raportimit të etikës dhe përgjegjësisë të gazetarëve në shoqëri

Shkup, 10 shkurt 2006